



Kosova Genç Birlik Derneği
Shoqata Unioni Rinor të Kosovës
Kosovske Omladine Uniji Udruženje
Kosovo Young Union Association

Organizata Jo-qeveritare
Kosova Genç Birlik Derneği
Shoqata Unioni Rinor të Kosovës
Kosovo Youth Union Association

STRATEGJIA E

Kosova Genç Birlik Derneği- KGBD

2027 - 2030

OJQ Kosova Genç Birlik Derneği (KGBD)
Rr. Joni 5-A-5, 20000/Prizren
www.kgbd.eu ~ info@kgbd.eu ~ 044-479-229

1. HYRJE

Strategjia

Gjatë dizajnit strategjik, është parë se më kryesore për KGBD është puna e saj shumëvjeqare në avokimin e të aktivizmit si dhe pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve me fokus të vecantë për të rinjtë. Kështu, KGBD synon të jetë më shumë se sa vetëm një organizatë e cila merret me trashëgiminë kulturore, mirëmbajtjen mjedisore apo qeverisjen e mirë.

Organizata ka për qëllim t'i mobilizojë dhe drejtoj resurset ekzistuese dhe të ardhshme për dedikuar në një komunikim të mirëfillt ndërmjet shoqërisë dhe qeverisë lokale në Prizren. Bazuar në kahjen e re strategjik, KGBD do të ketë orientim të drejtëpërdrejtë në rritjen e përfaqësimit dinjitoz jo vetëm të komunitetit turk në Kosovë por edhe pjesëtarëve tjerë të komuniteteve sic janë Boshnjakët, Romët, Ashqalit, Goranët dhe të tjerët.

Ky dokument përmbanë misionin, vizionin dhe vlerat e KGBD-së duke prezentuar punën e viteve të fundit dhe qëllimet strategjike për periudhën 2027-2030.

Misioni i organizatës përcaktohet si: KGBD angazhohet për qytetari aktive në jetësimin e politikave shoqëro kulturore të komunitetit, pjesëmarrje aktive në vendimarrje, nxitja e vullnetarizmit si dhe aftësim të rinjve në fusha të ndryshme. Në anën tjetër parimet e KGBD janë përcaktuar si; Paanësia, Barazia, Aktivizmi si dhe Profesionalizmi.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK I ORGANIZATËS:

Qëllimi Strategjik 1 – Avancimi i njohurive për bashkëveprim me qytetarët

Objektiva Strategjike 1.1 – Rritje e përfaqësimit të Organizatës në komunitet

Objektiva Strategjike 1.2 – Qëndrueshmëria e punës dhe aktiviteteve kulturore, me fokus në Prizren dhe në Rajonin e Prizrenit.

Qëllimi Strategjik 2 – Aktivizim rreth nevojave për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve

Objektiva Strategjike 2.1 – Koordinim me institucionet shtetërore për të mundësuar një komunikim të mirëfillt mes qytetarët dhe institucionet publike

Objektiva Strategjike 2.2 – Avancimi i profesionalizmit

Objektiva Strategjike 2.3. – Promovimi i KGBD

Qëllimi Strategjik 3 – Përfaqësimi dhe thellimi i bashkëpunimit me Organizata Ndërkombëtare

Objektiva Strategjike 3.1- Thellimi i bashkëpunimit me FUEN në fushën e kulturës ku KGBD është anëtarë me drejtë vote

Objektiva Strategjike 3.2- Përfaqësimi i KGBD në Rajon, dhe krijimi i partneriteteve të reja me organizata rajonale

2. VIZIONI DHE MISIONI

Arsyeja e themelimit të Shoqatës Unioni Rinor i Kosovës është besimi në njohuritë, përvojën, edukimin tonë dhe dëshirën të përdorim energjinë ekzistuese në mënyrë pozitive.

Vizioni ynë:

Përveç që jemi udhëheqës të së ardhmes të bëhemi edhe partnerët në ditët e së nesërës.

Misioni ynë :

Të promovojmë pjesëmarrjen e mekanizmave vendimmarrëse duke përmisuar kapacitete e të rinjve duke përdorur teknologjinë informative në mënyrë aktive.

Qëllimi:

Të bëhen aranzhime ligjore dhe institucionale për një politikë rinore në Kosovë.

Për të bërë një rini të qëndrueshëm për një zhvillim të qëndrueshëm dhe një mjedis të shëndetshëm.

Zhvillimi i partneriteteve rinore me qeverinë, qeveritë lokale dhe komunitetin e biznesit,

Të mbikqyrë Samitin e Kombeve të Bashkuara, Samitin e Bashkimit Evropian dhe takimet e tjera ndërkombëtare me interes për të rinjtë dhe për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në këto takime poashtu për të kontribuar në vendimet.

Sigurimi i komunikimit ndërmjet grupeve rinore dhe zhvillimit të programeve arsimore,

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë, formimi i platformave legjitime në të cilat do të takohen organizatat rinore dhe të rinjtë, këshillin e studentëve në shkollat e mesme, këshillin e studentëve në universitete, këshillin e rinisë në qeveritë lokale dhe të gjitha këto platforma të bashkohen për të bërë struktura kombëtare.

Objektivi ynë:

Deri në vitin 2030 të krijojmë Akademinë e Liderëve të rinj,

Të sigurojmë institucionalizimin e Parlamentit Kombëtarë të Rinisë,

Të mbështesim krijimin e Këshillave rinore në të gjitha regjionet e Kosovës,

Përgatitja e një ambienti të internetit për të gjitha punët e të rinjve.

Si?

Transferimi i informacionit nga niveli ndërkombëtarë në nivel kombëtarë dhe nga niveli kombëtarë në nivel ndërkombëtarë.

Ekzaminimi i praktikave të mira në botë dhe zbatimi në nivel lokal dhe kombëtarë

Përcjellja e axhendës botërore dhe krijimi i axhendës

Themelimi i solidaritetit të rinisë dhe shoqërisë civile

Të përshpejtohet procesi i demokratizimit duke rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë civile

Zhvillimi i ndjeshmërisë së komunitetit me vizionet e reja

Krijimi i një platforme rinore me mendime të përbashkët për të zgjidhur problemet sociale

Parimet tjera:

Civilizimi:

Në kuadër të projekteve që realizojmë ne punojmë me qeveritë të ndryshme lokale si (komunat dhe drejtorit regjionale). Ne inkurajojmë vullnetarizmin duke nxitur ndejnjen e të rinjve në përkatësi lokale. Megjithatë, gjëja kryesore në studimet tona është të krijojmë vetëdijen për problemet e përbashkëta të rinjve në nivel qyteti. Në këtë drejtim, ne nuk vendosim asnjë lloj diskriminimi në platformat rinore që kemi krijuar. Në të njëjtën kohë, kjo qasje që ne demostrojmë është zhvillimi i partneriteteve në mënyrë më efektive me autoritetet lokale.

Lokalitet:

Është e domosdoshme të kemi një dimension lokal të studimeve që kryejmë. Fakti që studimet të cilat kuptohen nga lokaliteti nuk janë sipërfaqësore. Pra, punojmë të mundësojmë njohjen dhe përvojën duke arritur në nivelin e lagjes. Në të njëjtën kohë mundohemi që mundësitë për rininë të arrijë në qytet tjera që janë lënë anash.

Përgjegjshmëria:

Shoqata jonë nuk hyn në marrëdhënie të drejtpërdrejta të parave dhe në marrëdhëniet e sponsorimit. Mbështetja financiare mbledhet për aktivitetin përkatës.

Lehtësimi:

Shoqata në qytetet ku organizon aktivitete i shmanget për të krijuar degë dhe njësi. Shoqata përmirson kapacitetet e grupeve të rinjve në qytet i lehtëson dhe i udhëzon ata për të formuar strukturat e tyre legjitime.

Partneriteti:

Shoqata nuk hyn në marrëdhënie vartëse me institucionet dhe organizatat me të cilat punojmë në kryerjen e studimeve të saj dhe mban pavarësinë e saj në hartimin e politikave. Vendimet në praktikën dhe punën e zakonshme bëhen me konsensus në bazë të partneritetit.

3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Qëllimet e saj KGBD synon ti përmbushë sipas objektivave si më poshtë:

- Përmes ndërgjegjësimit të publikut për rolin e aktorëve kyq institucional, shoqërisë civile dhe individit në ndërtimin e edukimit demokratik;
- Përmes përkrahjes dhe motivimit të publikut (sidomos të rinjve) drejt metodave të reja të pjesëmarrjes aktive, duke përdorur teknologjinë, mediat e reja (Fluid Democracy) në shërbim të rforcimit të demokracisë;
- Përmes aftësimit dhe ndërgjegjësimit të publikut për rolin qeverisës së mirë duke përfshirë edhe ndikimin të saj në proceset kulturore, ekonomike dhe shoqërore
- Përmes hulumtimit të procesit të komunikimit (procedurat, normat që mundësojnë transparencën dhe llogaridhënien, të drejtën e informimit;
- Përmes ofrimit të konsulencave, shërbimeve dhe përvojës në fushat e ndryshme që kanë të bëjnë me interesin publik;
- Përmes mbledhjes së informacioneve në terren dhe përpunimit cilësor dhe sasior të të dhënave gjithëpërfshirëse;
- Përmes mbledhjes së informacioneve në terren dhe përpunimit cilësor dhe sasior të të dhënave mbi situatën dhe zhvillimin e medias dhe teknologjive të komunikimit, institucioneve, kornizës ligjore dhe rregullative të kulturës në Kosovë
- Përmes hulumtimeve dhe projekteve të shumta që masin impaktin e komuniteteve dhe teknologjive inovative të komunikimit brenda dhe jashtë vendit
- Përmes të angazhimit për çështje të ndryshme të demokracisë, medias dhe kulturës dhe inicimit të debateve dhe dialogut, operatorëve të medias, shoqërisë civile, qeverise në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

- Përmes organizimit të konferencave, seminareve, workshop-eve, trajnimeve dhe kurseve kualifikuese brenda dhe jashtë vendit për çështje dhe tematika që lidhen me zhvillimin e demokracisë dhe kulturës

4. MODULET E ORGANIZATËS

Duke filluar nga viti 2024 KGBD do të funksionojë me këto programe:

1. Komunitetet aktive në vendimmarje

Përkrahja e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë është thelbi i angazhimeve tona të punës si KGBD-it. Krijimi i organizatës burin nga aktivizmi i komuniteteve vecantërisht të rinjve. Komunitetet aktiv në vendimmarje do të përkrahët përmes iniciativave tona dhe modulit të ri të organizatës dhe do të përfshijë rolin e rëndësishëm të KGBD-it në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile në Prizren. Kësisoj, KGBD do të thelloj punët e saja konform të drejtave të komuniteteve jo shumicë dhe përfaqësimin e tyre aktive në proceset vendimmarëse.


2. Promovimi dhe përfaqësimi kulturor

Promovimi kulturor dhe përfaqësimi dinjitoz i saj do të jetë pjesë kryesore e angazhimeve tona duke pasqyruar diversitetin kulturor dhe bashkëjetesën në paqe. Me zbatimin e objektivave e lartëcekura do të vazhdojmë të ndërtojmë një shoqëri të hapur dhe të informuar për vlerat e tyre shoqëro kulturore.

3. Hulumtimi dhe Analiza

KGBD do të filloj të implementojë publikimin e hulumtimeve dhe analizave në forma të lexeshme për qytetarët. Do të angazhojë ekspertë dhe njohës së brendshëm dhe të jashtëm për funksionalizimin e plotë të këtij moduli.

4.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE



Strategjia e Kosova Genç Birlik Derneği/ Shoqata Unioni Rinor të Kosovës 2027-2030 u miratua ne takimin vjetor te Kuvendit te Anetareve te KGBD, mbajtur me 25 Gusht 2025, ne Prizren